Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-331
Datë: 13.10.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 15.09.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet N.SH. KAS me katër lokacione në Prishtinë me adresë Rruga Bajram Kelmendi p. n, në Ferizaj me adresë Rruga 12 Qershori, në Gjilan me adresë Rruga Mulla Idrizi dhe në Kamenicë me adresë Rruga Fehmi Agani për periudhën 15.09.2017 deri 15.09.2020 me kualifikimet:

   1.1. Grimer/Grimere, Niveli III sipas KKK me 38 kredi të AAP.
   1.2. Manikyrist/Manikyrise, Niveli III sipas KKK me 6 kredi të AAP.
   1.3. Pedikyrist/Pedikyriste, Niveli III sipas KKK me 6 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

Grimer/Grimere

2.1. Stafi që përfshin trajnerët dhe asistentet në profilin e grimit, duhet në mënyrë imediate të njohin/studiojnë planprogramin nga ana teorike që të jenë në gjendje për ta transmetuar atë në mënyrë korrekte tek kandidatët që do të vijojnë në këtë profil.

2.2. Trajnim i domosdoshëm për të gjithë trajnerët dhe asistentët në pjesën pedagogjike, metodik dhe didaktikë për të zhvilluar procesin e mësimdhënies.

2.3. Stafi të trajnohet për kandidatët me aftësi të kufizuara, për të patur sa më të lehtë implementimin e programit te grimit, pasi në këtë qendër janë krijuar të gjitha mundësitë që të trajnohen këta individë.

2.4. Të vendoset kodi i mirësjelljes brenda hapësirave ku zhvillohen trajnimet, në të gjitha qendrat.

2.5. Të dokumentohet dhe të paraqitet në gjuhën shqipe i gjithë materiali shpjegues për profilin e grimit, që detyrimisht të ofrohet në skript kandidatëve.

2.6. Të ketë një datë të vetme për fillimin e çdo grupi të ri që kandidatët të trajnohen në të njëjtën kohë, të paktën për sa i përket pjesës teorike.

2.7. Modulet e paraqitura në planprogram të jenë në përputhshmëri me standardin e grimit të aprovuar nga MASHT-i.

2.8. Të organizohet vlerësimi përfundimtar i kandidatëve dhe në panel të jetë dhe një vlerësues i jashtëm nga industria e bukurisë në rajon.

2.9. Trajnimi i trajnerëve për nevoja emergjente në rast zjarri.

2.10. Trajnimi i trajnerëve dhe asistentëve për ndihmën e parë.

2.11. Trajnerët të jenë njohës për modulet e programit të grimit, të cilën duhen ta zhvillojnë në teori dhe praktikë.

2.12. Të kompletohet literatura për pjesën teorike dhe praktike në programin e grimit dhe te pajisen kandidatët me literaturë të qendrës.

Manikyrist/Manikyrise

2.1. Stafi që përfshin trajnerët dhe asistentet në profilin e manikyrit, duhet në mënyrë imediate të njohin/studiojnë planprogramin nga ana teorike që të jenë në gjendje për ta transmetuar atë në mënyrë korrekte tek kandidatët që do të vijojnë në këtë profil.

2.2. Trajnim i domosdoshëm për të gjithë trajnerët dhe asistentët në pjesën pedagogjike, metodik dhe didaktikë për të zhvilluar procesin e mësimdhënies

2.3. Të zhvillohen procedurat përkatëse për vlerësim dhe testim formativ dhe sumativ;

2.4. Hartim i politikave për zhvillim profesional të stafit mësimdhënës/trajner në aspektin metodik dhe didaktik si dhe certifikimi i tyre;

2.5. Organizimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një manikyrist/e të kualifikuar nga sektori privat);

2.6. Në skemën e aplikacionit për validim nuk janë të detajuara orët teorike, orët praktike dhe orët e vlerësimit të shprehura ne orë dhe përqindje;

2.7. Të kompletohet literatura për çdo modul në pjesën teorike dhe praktike.

2.8. Kualifikimi i domosdoshëm i të gjithë trajnerëve dhe asistentëve në pjesën profesionale, po ashtu edhe në pjesën pedagogjike dhe metodologjike për të zhvilluar procesin e mësimdhënies;

2.9. Trajnimi i trajnerëve dhe asistentëve për ndihmën e parë;

2.10. Modulet e publikuara të jenë në përputhshmëri me standardin e grimit, e aprovuar nga MASHT;

2.11. Trajnerët të jenë të njoftuar për modulet e programit të manikyrit, të cilën duhen ta zhvillojnë në teori dhe praktikë;

2.12. Të kompletohet literatura për pjesën teorike dhe praktike në programin e manikyrit, dhe të pajisen kandidatët me literaturë të qendrës;

2.13. Të organizohet vlerësimi përfundimtar i kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm.

Pedikyrist/Pedikyriste

2.1. Stafi që përfshin trajnerët dhe asistentet në profilin e pedikyrit, duhet në mënyrë imediate të njohin/studiojnë planprogramin nga ana teorike që të jenë në gjendje për ta transmetuar atë në mënyrë korrekte tek kandidatët që do të vijojnë në këtë profil.

2.2. Trajnim i domosdoshëm për të gjithë trajnerët dhe asistentët në pjesën pedagogjike, metodik dhe didaktikë për të zhvilluar procesin e mësimdhënies.

2.3. Të zhvillohen procedurat përkatëse për vlerësim dhe testim formativ dhe sumativ.

2.4. Hartim i politikave për zhvillim profesional të stafit mësimdhënës/trajnerëve në aspektin metodik dhe didaktik si dhe certifikimi i tyre.

2.5. Organizimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm (përfshirë në panel edhe një pedikyrist/e të kualifikuar nga sektori privat).

2.6. Vlerësimi të bëhet me pikë dhe jo nota.

2.7. Në skemën e aplikacionit për validim nuk janë të detajuara orët teorike, orët praktike dhe orët e vlerësimit të shprehura ne orë dhe përqindje.

2.8. Të kompletohet literatura për çdo modul në pjesën teorike dhe praktike.

2.9. Kualifikimi i domosdoshëm i të gjithë trajnerëve dhe asistentëve në pjesën profesionale, po ashtu edhe në pjesën pedagogjike dhe metodologjike për të zhvilluar procesin e mësimdhënies.

2.10. Trajnimi i trajnerëve dhe asistentëve për ndihmën e parë.

2.11. Modulet e publikuara të jenë në përputhshmëri me standardin e pedikyrit, e aprovuar nga MASHT-i.

2.12. Trajnerët të jenë të njoftuar për modulet e programit të pedikyrit, të cilën duhen ta zhvillojnë në teori dhe praktikë.

2.13. Të kompletohet literatura për pjesën teorike dhe praktike në programin e pedikyrit dhe të pajisen kandidatët me literaturë të qendrës.

2.14. Të organizohet vlerësimi përfundimtar i kandidatëve, mundësisht me vlerësues të jashtëm.

2.15. Të ofrohen më tepër vende pune (shtretër) për realizimin e punës praktike.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datat 30.12.2017 sipas raporteve të jashtme vlerësuese për secilin kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:
   -DBBS;
   - AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së